



RREGULLORJA E ZGJEDHJEVE

Neni 1
Baza Ligjore

1. Kjo rregullore bazohet në Ligjin 40/2016 “Për Urdhrin e Psikologut në Republikën e Shqipërisë”.

Neni 2
Objekti i Rregullores

1. Kjo rregullore ka për objekt përgatitjen, organizimin, zhvillimin, administrimin, mbledhjen dhe shpalljen e rezultateve të zgjedhjeve për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut.

Neni 3
Parimet e përgjithshme

1. Zgjedhjet për organet drejtuese të Urdhrit të Psikologut janë periodike dhe mbahen çdo 4 vjet.
2. Të drejtën për të zgjedhur dhe për t’u zgjedhur e gëzon çdo anëtar i UP-së, sipas kriterëve të përcaktuar në ligj.
3. Votimi është vetjak. Vota nuk mund të delegohet.
4. Votimi është i fshehtë.
5. Zgjedhja e kandidatëve bëhet me vullnet të lirë dhe në mënyrë të fshehtë, sipas rregullave të parashikuara në këtë Rregullore.
6. Çdo zgjedhës ka të drejtën e një vote të vetme për zgjedhjen e çdonjërit prej kandidatëve për organet drejtuese të Urdhrit.
7. Çdo kandidat nuk mund të konkurrojë njëkohësisht për më shumë se një post në organet drejtuese të Urdhrit.
8. Shpallet fitues kandidati/ kandidatët, i cili/ të cilët kanë fituar më shumë vota të vlefshme.
9. Këshilli Kombëtar është organi përgjegjës për shqyrtimin e të gjitha llojeve të ankimeve të parashikuara në këtë rregullore.
10. Në rast se zgjedhjet përsëriten për çfarëdolloj arsyeje, zbatohen sërish të njëjtat procedura për zhvillimin e tyre të parashikuara në këtë rregullore.

Neni 4

Caktimi i datës së zgjedhjeve

1. Presidenti cakton datën e mbledhjes së Asamblesë për mbajtjen e zgjedhjeve jo më herët se 1 muaj dhe jo më vonë se dy muaj nga afati i përfundimit të mandatit të organeve drejtuese të Urdhrit të Psikologut.
2. Në rast të gjendjeve të jashtëzakonshme apo pamundësisë objektive për mbledhjen e asamblesë për shkak të forcave madhore, ky afat mund të zgjatet deri në përfundimin e tyre.
3. Anëtarët e organeve drejtuese të Urdhrit të Psikologut qëndrojnë në detyrë deri në momentin e zëvendësimit të tyre prej anëtarëve të zgjedhur rishtaz.
4. Në rast të mosushtrimit të kësaj kompetence nga Presidenti, me kërkesë të 1/3 të anëtarëve të tij, Këshilli Kombëtar mblidhet dhe ushtron vetë këtë kompetencë.

Neni 5

Caktimi i afatit për kandidim

1. Çdo person i interesuar mund të paraqesë kandidaturën e tij jo më vonë se 30 ditë përpara datës së caktuar për zgjedhjet.
2. **Një subjekt nuk mund të kandidojë në dy kategori të ndryshme.**

Neni 6

Verifikimi i kandidaturave

1. Zyra Juridike e Urdhrit të Psikologut bën verifikimin e plotësimit të kriterëve për kandidim për secalin nga kandidatët dhe i bën ato publike, jo më vonë se 10 ditë nga mbyllja e afatit të kandidimit.
2. Kundër vendimit për mosvlerësimin e kriterëve të kandidatit në përputhje me ligjin, kandidati të cilit i është refuzuar kandidimi, ka të drejtë të ankohet në Këshillin Kombëtar brenda 3 ditëve nga shpallja publike.
3. Këshilli Kombëtar i shqyrton ankesat brenda 5 ditëve nga depozitimi i tyre.

Neni 7

Mënyra e zgjedhjes

- 1. Zgjedhja e Presidentit** bëhet me votim të drejtpërdrejtë midis kandidaturave që plotësojnë kriteret ligjore në një fletë të vecantë votimi, ku secili zgjedhës do votojë për një kandidat, kandidatura e të cilit është verifikuara nga Zyra Juridike. Në fletën e votimit do të listohen (sipas alfabetit apo me short) të gjithë subjektet që kandidojnë. **Cdo votues do të votojë për një subjekt në listën e kandidaturave në fletën e votimit.** Në mbyllje të numërimit të votave të vlefshme, subjekti që ka mbledhur më shumë vota shpallet fitues.
- 2. Për zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit të Kombëtar,** në fletën e votimit do të listohen sipas alfabetit të gjithë subjektet që kandidojnë, nga universitetet private apo shtetërore, duke u shënuar përkrah emrit universiteti ku punojnë aktualisht. **Cdo votues do të votojë për tre subjekte** në listën e kandidaturave në fletën e votimit. Në mbyllje të numërimit të votave të vlefshme, tre subjektet që kanë mbledhur më shumë vota shpallen fitues.
- 3. Shtatë anëtarë** do të zgjidhen nga kandidaturat e psikologëve që punojnë në shkolla, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, në zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie. Në fletën e votimit do të listohen sipas alfabetit **të gjithë subjektet që kandidojnë**, pavarësisht nga fusha, duke u shënuar përkrah emrit institucioni ku punojnë aktualisht. **Cdo votues do të votojë për shtatë subjekte** në listën e kandidaturave në këtë fletë votimi. Në mbyllje të numërimit të votave të vlefshme, shtatë subjektet që kanë mbledhur më shumë vota shpallen fitues.
- 4. Një anëtar** do të zgjidhet nga shoqatat e psikologëve. Në fletën e votimit do të listohen (sipas alfabetit apo me short) të gjithë subjektet që kandidojnë, duke u shënuar përkrah emrit shoqata nga e cila kandidon. **Cdo votues do të votojë për një subjekt në listën e kandidaturave në fletën e votimit.** Në mbyllje të numërimit të votave të vlefshme, subjekti që ka mbledhur më shumë vota shpallet fitues.
- Në rastet kur kandidon vetëm një kandidat për një vend fitues, kandidati shpallet fitues nëse ka mbledhur më shumë vota pro se kundër nga votat e vlefshme.
- Në rastet kur për 2 apo më shumë kandidatë do të kemi barazim votash, atëherë do të kemi ripërsëritje të votimit.

Neni 8

Lista e dokumentacionit të kërkuar për kandidim

1. Dokumentacioni i kërkuar për kandidatët për president:

- Dëshmi e penalitetit
- Curriculum vitae
- Vërtetim nga punëdhënësi ose nga sigurimet shoqërore për eksperiencën në punë **(origjinal)** ose kopje e librezës së punës, **të njehsuar me origjinalin (e rifreskuar)**.
- Dëshmi, vërtetim ose cdo dokument që provon eksperiencën në funksione drejtuese në institucione, ente, organizma, shoqata, etj. publike ose private **(origjinal)** **(e rifreskuar)**
- Botime shkencore të publikuara

2. Dokumentacioni i kërkuar për kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar (pedagogë)

- Dëshmi e penalitetit
- Kopje të titujve shkencore **të njehsuar njësisht me origjinalin**.
- Vërtetim nga Universiteti ku punojnë **(origjinal)**, që dëshmon për eksperiencën 5 vjeçare në këtë fushë. **(e rifreskuar)**

3. Dokumentacioni i kërkuar për kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar (psikologë që punojnë në shkollë, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, në zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie)

- Dëshmi e penalitetit
- **Vërtetim për eksperiencën mbi 5 vjet vjetërsi në punë të vërtetuara nga institucioni ku punojnë (origjinal) (e rifreskuar)**

4. Dokumentacioni i kërkuar për kandidatët për anëtarë të Këshillit Kombëtar (psikologë nga shoqatat)

- Dëshmi e penalitetit
- Vërtetim për eksperiencën pesë vjeçare të punës si psikolog **(origjinal)** **(e rifreskuar)**
- Vërtetim për anëtarësinë në shoqatë **(origjinal)** **(e rifreskuar)**

- vendim gjykate ose vërtetim nga Regjistri I OJF-ve për shoqatëen **(e njehsuar me origjinalin)**
- Certifikaten e regjistrimit të shoqatës si person i tatueshem NIPT **(e njehsuar me origjinalin)**

Neni 9

Procedura e votimit

1. Regjistri i Anëtarësisë i Urdhrit të Psikologut, i përditësuar, shërben si Listë Votuesish për zgjedhjen e organeve drejtuese të Urdhërit.
2. Fletët e votimit përgatiten nga administrata e Urdhrit të Psikologut, sipas formatit bashkëngjitur kësaj rregulloreje dhe vulosen me vulën e zyrës juridike të Urdhrit të Psikologut.
3. Votimi bëhet i fshehtë, në një mjedis që garanton fshehtësinë e votës.
4. Administrimi i zgjedhjeve bëhet nga administrata e Urdhrit të Psikologut. Çdo kandidat ka të drejtë të autorizojë me shkrim një vëzhgues që ka të drejtën të monitorojë pa asnjë pengesë të gjitha veprimet e kryera nga administrata gjatë administrimit të procesit të votimit, përfshirë numërimin e votimeve. Vëzhguesit kanë të drejtë të paraqesin pranë Këshillit Kombëtar çdo ankesë apo observim, në emër të kandidatëve që përfaqësojnë, në lidhje me rregullsinë e procesit zgjedhor.
5. Në momentin që një votues paraqitet për të votuar, identifikohet sipas kartës së anëtarësisë së Urdhrit të Psikologut të vlefshme për vitin në vijim. Në Listën e Votuesve bëhet një shenjë dalluese për të identifikuar personin që voton. Pasi pajiset me katër fletë votimi, sipas çdo fushe kandidimi, votuesi shkon në mjedisin e posaçëm, plotëson fletën e votimit dhe e hedh në kutinë përkatëse. Orari i votimit është 10:00 – 15:00.
6. Pas përfundimit të procedurës për çdo votues të pranishëm, pasi kalon afati kohor i përcaktuar për mbylljen e votimit, kryhet numërimi i votave në mënyrë publike. Askush nuk mund të votojë pas orës së mbylljes së votimit, me përjashtim të zgjedhësve që presin për të votuar në kohën e mbylljes.
7. Numërimi i votave bëhet i vecantë për çdo fushë kandidimi. Fleta e votimit konsiderohet e pavlefshme në rast se:
 - është votuar për më shumë ose më pak kandidatë se numri i përcaktuar në fletën e votimit;
 - kur nuk është e qartë se për cilin është votuar;
 - kur fleta përmban shënime që mund të zbulojnë identitetin e zgjedhësit

- kur zgjedhësi ka bërë shënime të tjera ose ka futur në listë një person që nuk është përfshirë në kandidim,

- kur fleta e votimit është e bardhë.

8. Në mbyllje të numërimit, Zyra Juridike përpilon Procesverbalin përkatës të numërimit që përmban numrin e votuesve gjithsej, numrin e votave të vlefshme, numrin e votave të pavlefshme, rezultatin për çdo fushë kandidimi, si më poshtë:

a. Për President të Urdhrit, renditja e kandidaturave bëhet sipas numrit më të madh të votave të vlefshme të grumbulluara në fletëvotimet përkatëse.

b. Për anëtarët e Këshillit Kombëtar që zgjidhen nga rradhët e pedagogëve, renditja e kandidaturave bëhet sipas numrit më të madh të votave të vlefshme të grumbulluara në fletëvotimet përkatëse.

c. Për anëtarët e Këshillit Kombëtar, që zgjidhen nga kandidaturat e psikologëve që punojnë në shkolla, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, në zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie, renditja e kandidaturave bëhet sipas numrit më të madh të votave të vlefshme të grumbulluara në fletëvotimet përkatëse.

d. Për anëtarin e Këshillit Kombëtar, që zgjidhet nga shoqatat, renditja e kandidaturave bëhet sipas numrit më të madh të votave të vlefshme të grumbulluara në fletëvotimet përkatëse.

9. Administrata e Urdhrit të Psikologut është organi përgjegjës për të dokumentuar me procesverbal të gjithë numërimin sa më sipër, të cilin, bashkë me procesverbalet, si dhe materialet e tjera zgjedhore, i ruan të sekretuara dhe ia përcjell Këshillit Kombëtar.

10. Cdo ankesë në lidhje me procesin zgjedhor i paraqitet Këshillit Kombëtar brenda 3 ditëve nga dita e zgjedhjeve.

11. Këshilli Kombëtar shqyrton ankesat e mundshme të depozituara pranë tij në lidhje me zgjedhjet brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit të ankimeve.

12. Në përfundim të afatit të shqyrtimit të ankesave, Zyra Juridike shpall kandidaturat fituese, sipas ligjit.

Miratuar me anë të Vendimit Nr.2 , datë 03.02.2021 të Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut.

Formati i fletëve të votimit

Aneks A

Fleta e votimit për President të Urdhrit të Psikologut

**FLETË VOTIMI
PËR PRESIDENTIN E URDHËRIT TË PSIKOLOGUT**

Vendosni njërën nga shenjat +, -, × përkrah emrit të subjektit që dëshironi të votoni. Cdo shënim tjetër në fletën e votimit e bën fletën të pavlefshme. Plotësimi i më shumë se një kutie e bën fletën të pavlefshme.

Nr.	Emri	Mbiemri	
1			
2			
3			
4			

Komisioni

Vula

Aneks B)

Fleta e votimit për Anëtarët e Këshillit Kombëtar të Urdhrit të Psikologut të zgjedhur nga rradhët e pedagogëve

FLETË VOTIMI
PËR ANËTARË TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË URDHËRIT TË PSIKOLOGUT
(PEDAGOGË)

*Vendosni një rënë nga shenjat +, -, × përkrah **tre** emrave të subjekteve që dëshironi të votoni. Cdo shënim tjetër në fletën e votimit e bën fletën të pavlefshme. Plotësimi i më shumë apo më pak se tre kutive e bën fletën të pavlefshme.*

Nr.	Emri	Mbiemri	Univeristeti	

Komisioni

Vula

Aneks C)

Fleta e votimit për Anëtarët e Këshillit Kombtar të Urdhrit të Psikologut të zgjedhur nga rradhët e psikologëve që punojnë në shkolla, spitale, burgje, institucione komunitare, gjykatë, në zyra apo agjenci private, institucione rezidenciale, si dhe institucione varësie

FLETË VOTIMI

PËR ANËTARË TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË URDHËRIT TË PSIKOLOGUT (PSIKOLOGË QË PUNOJNË NË SHKOLLA, SPITALE, BURGJE, INSTITUCIONE KOMUNITARE, GJYKATË, NË ZYRA APO AGJENCI PRIVATE, INSTITUCIONE REZIDENCIALE, SI DHE INSTITUCIONE VARËSIE;)

Vendosni një rënë nga shenjat +, -, × përkrah emrit të shtatë subjekteve që dëshironi të votoni.
Cdo shënim tjetër në fletën e votimit e bën fletën të pavlefshme. Plotësimi i më shumë apo më pak se shtatë kutive e bën fletën të pavlefshme.

Nr.	Emri	Mbiemri	Institucioni	

Aneks D)

Fleta e votimit për Anëtarët e Këshillit Kombtar të Urdhrit të Psikologut të zgjedhur nga rradhët e shoqatave

FLETË VOTIMI
PËR ANËTARË TË KËSHILLIT KOMBËTAR TË URDHËRIT TË PSIKOLOGUT
(PSIKOLOGË PËRFAQSUES TË SHOQATAVE)

Vendosni njëzën nga shenjat +, -, × përkrah emrit të subjektit që dëshironi të votoni. Cdo shënim tjetër në fletën e votimit e bën fletën të pavlefshme. Plotësimi i me shumë se një kutie e bën fletën të pavlefshme.

Nr.	Emri	Mbiemri	SHOQATA	

Komisioni

Vula